



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.22/2018

Prishtinë, më 25 maj 2018

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Miljana Nikoliq, Saranda Bogujevci, Frashër Krasniqi, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Teuta Haxhiu dhe Albulena Balaj- Halimaj.

Mungoi: Mirjeta Kalludra.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Idriz Blakaj-Drejtor i Agjencisë për Mbrojtjen e Komplekseve Memoriale, Pajtim Çuni-Radio Kosova, Besiana Bajrami-Ekonomia Online dhe Sahadete Zogaj- Kosova Press.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e Komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë.

Rend dite:

- 1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,**
- 2. Raportimi në Komision lidhur me gjendjen e memorialëve të Kosovës.**

Të ftuar në këtë mbledhje të komisionit janë përfaqësues të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale dhe Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur;

3. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryetarja, konstatoi se procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 18 prill 2018, u miratua pa vërejtje.

2. Raportimi në Komision lidhur me gjendjen e memorialëve të Kosovës.

Të ftuar në këtë mbledhje të komisionit janë përfaqësues të: Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë dhe Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur

Kryetarja tha se kemi prezent drejtorin e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë z. Idriz Blakaj, për të biseduar për Kompleksin Memorial në Meje, kemi ftuar edhe Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, por ata janë zyrtarisht jashtë vendit.

Idriz Blakaj tha se Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë është formuar në vitin 2013, me ligj të miratuar nga Kuvendi.

Për komplekset memorialë aty ku është ndarë buxhet është punuar, në disa sosh puna vazhdon ende, e kemi dërguar një listë se cilat janë komplekset që janë përfunduar, cilat janë duke vazhduar punimet dhe të cilat mirëmbahen.

Sa i përket kompleksit memorial në Meje, vitin e kaluar i janë ndarë Agjencisë 300 mijë euro për rregullimin e varrezave, sepse kompleksi i Mejes përfshinë edhe objekte të tjera, parashihen investime rreth 1 milion e gjysmë euro, por këto mjete kanë qenë të ndara vetëm për rregullimin e varrezave më vonë janë ndarë edhe 100 mijë euro të tjera. Fillimisht kishim probleme sepse për kompleksin e Mejes është shpallur një tender me herët nga Komuna e Gjakovës, është bërë kontrata me një kompani vendore atje janë kryer disa punë, por më vonë kanë ngecur, arsyetimi ka qenë se nuk ka pasur mjete Komuna për t'i paguar. Qeveria nuk i ka ndarë mjetet, kështu që punët kanë ngecur, janë bërë 4 vjet prej se ka filluar kontrata me atë kompani dhe puna ka mbetur thuajse ku ka qenë në fillim. Më pas, pasi që i janë ndarë mjetet agjencisë, komuna ka kërkuar prej nesh që të vazhdojmë kontratën me kompaninë e cila ka filluar punën, mirëpo me Ligj të Prokurimit Publik lejohet që kontrata të zgjatë maksimum tri vjet dhe këtu kishin kaluar vetëm katër vjet, pas këtyre ne kemi shpallur tenderin në prill të vitit të kaluar, në qershor është bërë kontrata dhe ka filluar puna. Fillimisht janë paraqitur disa probleme me shoqatën 27 prilli që i përfaqëson familjet e dëshmorëve të Mejes dhe ka pasur mosmarrëveshje rreth formës së varrit, por ne nuk kemi pranuar që të këtë dallime në varreza dhe kemi arritur marrëveshjen që varrezat të bëhen të njëjta për të gjithë, më vonë pasi ka filluar vendosja e kupëzave më kanë thënë përfaqësuesit e shoqatës se ato nuk janë vendosur mirë, por pas disa konsultimeve këto probleme janë tejkaluar dhe tani punët janë në rregull. Punët në atë kompleks nuk kanë përfunduar ende, pranimi teknik nuk është bërë ende. Jemi

marrë vesh që kur të bëhet pranimi teknik të jetë prezent edhe një përfaqësues i shoqatës 27 prilli, puna do të kryhet besoj deri ka mesi i qershorit.

Teuta Haxhiu tha se shqetësimi i saj si deputete ka qenë sepse personalisht e kanë kontaktuar anëtarët e shoqatës 27 prilli dhe kanë shprehur pakënaqësi me ndërtime të varrezave dhe ajo është e dukshme.

Ajo pyeti se si Institucion sa herë keni dërguar shkresë të kompania për shqetësimin e familjarëve apo shoqatës, a i jeni drejtuar kompanisë apo komunës për punimet jo në rregull dhe sa herë i keni vizituar deri në prill të vitit 2018 ato punime që po bëhen.

Saranda Bogujevci pyeti se a ka pasur konsultime me familjarët para se me u realizuar projekti dhe kush e ka bërë projektin.

Sa i përket shqetësimeve që janë ngrit sa u përket çështjeve fetare, ka pasur mundësi me u marrë shembuj prej rajonit, dhe përmendi memorialin në Srebrenicë. Te memorialët nuk është çështja të dihen vetëm emrat por të tregohet edhe një histori se çka ka ndodhur me këta persona gjatë luftës.

Mexhide Mjaku-Topalli u tha që ka pasur mosmarrëveshje sa u përket çështjeve fetare të familjarët e martirëve dhe a e ka vonuar procesin kjo çështje. Ka informata që komuna ka qenë fajtorë pse e ka ndërprerë punën për shkak të mos ndarjes së mjeteve buxhetore nga qeveria direkt të kontraktuesi, dhe pse ka ndodhur që të njëjtit kontraktues t'i vazhdohet prapë puna.

Idriz Blakaj, sa i përket çmimit të varrit, tha se shoqata 27 Prilli që i përfaqëson familjarët bashkë me një arkitekt të tyre kanë kërkuar që aty të vendoset një lloj i granitit që gjendet vetëm në Afrikë dhe është më i shtrenjtë se granitet që gjinden në Kosovë dhe vendet e Evropës. Çmimi i saj mund të vërtetohet në çdo kohë, nuk ka projekt që e kam vizituar më shumë se sa projektin e Mejës, nuk është e vërtetë se punët janë duke u bërë shumë keq, ka pasur të meta por i kemi korrigjuar dhe ajo ka me u krye sipas standardeve më të mira që ekzistojnë. Sa i përket projektit, është bërë nga komuna dhe nuk e dijë a janë konsultuar familjarët. Ne e kemi marrë projektin mbasi janë ndarë ato 300 mijë euro dhe nuk kemi ndërruar asgjë në projekt sepse për ndryshime duhet me marrë pëlqimin e kontraktuesit, varrezat janë të njëjta në format.

Teuta Haxhiu shqetësimi im është se m' u ka drejtuar shoqata dhe shqetësimet e familjarëve janë se varrezat ato nuk janë në gjendje të mirë. Ajo tha se i ka fotografitë e varrezave. A i keni shkruar ndonjëherë dikujt ndonjë letër për shqetësimet që i kanë pasur familjarët dhe shoqata. Po e presim qershorin dhe uroj të ndodhë kështu dhe të hiqen shqetësimet e familjarëve.

Idriz Blakaj tha se sa herë më kanë thirrur për shqetësime kamë qenë në Gjakovë, këtë e dinë familjarët edhe kompania, kompleksi ka me u krye qysh duhet. Ai tha se është mirë të fillojnë hetimet lidhur me çdo keqpërdorim të mundshëm.

Kryetarja e falënderoj drejtorin e Agjencisë për Mbrojtjen e Memorialëve për informata dhe tha se kemi kuptuar që rasti është në Prokurori. Si Komision kemi planifikuar me dalë edhe në terren, por do të bisedojmë edhe me Komisionin Qeveritar për Persona të Zhdukur.

3. Të ndryshme

Mexhide Mjaku-Topalli tha se para dy dite ishim prezent në Dubravë në përkujtim të Masakrës së Dubravës dhe propozoi që Komisioni Për të Drejta të Njeriut dhe Komisioni për Media të takohen, të formojnë një këshill organizativ të përbashkët në mënyrë që në vitin 2019, të jetë ajo ditë me e organizuar.

Ajo kërkoi mbështetjen që me një amendament që kur të vjen projektligji për rishqyrtim të buxhetit, të kërkojmë që të ndërtohet një memorial të fusha sportive në burgun e Dubravës, aty ku ka ndodhur krimi ndaj të burgosurve.

Do të ishte mirë të kemi një takim të përbashkët duke ftuar Natasha Kandiç dhe Komisionin për Hetime të Krimeve të Luftës në Kosovë, në mënyrë që ta kemi një takim të përbashkët dhe të diskutojmë për çështjet se ku kanë mbetur si procedura lidhur me dënimin e kryerësve të kësaj masakre.

Teuta Haxhiu tha se kur ishim në Dubravë ju kamë premtua familjarëve se kam me ngritur në seancë çështjen e ngritjes së një pllake me emrat e të gjithë të vrarëve, dhe duhet të punojmë bashkërisht që ta bëjmë një amendament në projektligjin për rishqyrtim të buxhetit.

Luljeta Veselaj-Gutaj njoftoi për ecurinë e monitorimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, por shprehi pakënaqësinë lidhur me pjesëmarrjen e numrit të pakët të pjesëmarrjes së anëtarëve të komisionit gjatë vizitave në monitorim. Ajo njoftoi se cilat institucione dhe komuna kanë vizituar deri më tani lidhur me këtë çështje.

Teuta Haxhiu tha se gjatë monitorimit të ligjeve është mirë që agjendat e komisionit të dalin mirë, dhe për atë është mirë me marrë pjesë të dy grupet punuese.

Lirije Kajtazi tha se aty ku mundemi është mirë me u bashkuar grupet punuese për monitorim të Ligjit për Barazi Gjinore dhe për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe t'i bëjmë vizitat e përbashkëta. Ajo propozoi se kur të vizitohet Komuna e Gjilanit të marrin pjesë të dy grupet.

Kryetarja kërkoi që Ministrisë së Arsimit t'i adresohemi me një shkresë që të na informojnë lidhur me çështjen e arsimit të personave të rritur të cilët nuk kanë vijuar arsimin fillorë në Republikën e Kosovës.

Më pas ajo tha se të gjithë jemi prekur me rastin që ndodhi me fëmijën 14 vjeçar në një fshat të Komunës së Kamenicës, dhe ne, si Komision, duhet të reagojmë lidhur me këtë rast.

Komisioni lidhur me këtë vendosi të bëjë një Komunikatë për media.

Kryetarja tha se ka pranuar e-mailit nga Iniciativa e Personave të Verbër, lidhur me çështjet e ngritura nga ta, kishim në takim Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ata përmes e-mailit kërkojnë prapë takim me ministrinë, sepse ministri nuk ka ndërmarrë asgjë nga takimi i fundit.

Sarnda Bogujevci tha se është mirë me ju shkruar nga një e-mail zyrtar, ministrit të MPMS-së dhe MAP-it, ku në bazë të kërkesave që kanë qenë në takimin e fundit të përgjigjen me shkrim se çka kanë ndërmarrë lidhur me kërkesat e personave të verbër prej takimit të fundit të përbashkët që kishim në komision.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit

Kryetarja e komisionit,

Duda Balje